



ZYRA E KRYETARIT TË KOMUNËS

01-Nr- ~~181~~-2635

Më datë 17.01.2018

Kryetari i Komunës së Suharekës, në mbështetje të nenin 13, nenin 58, paragrafi 1, pika (f) lidhur me nenin 62, paragrafi 2, të Ligjit Nr-03/L-040, për vetëqeverisje lokale "Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr-28/2008" dhe nenit 30 dhe 45 paragrafi 1 pika (d) të Statutit të Komunës së Suharekës 01-Nr-8336 të 04.11.2008, e duke u bazuar në Vendimin për emërtimin, organizimin dhe caktimin e numrit të Drejtorive të Komunës së Suharekës, 01-Nr-016-2427 të datës 17.01.2018, nxjerr këtë:

V E N D I M

Për emërimin e Drejtorit të Drejtorisë

1. **Emrush BYTYÇI** i lindur me 27.01.1984 në fshatin Mushtisht, Komuna e Suharekës, me profesion Jurist i diplomuar, **emërohet** Drejtor i Drejtorisë për Shërbime Pronësoresh Juridike dhe Kadastër, në Komunën e Suharekës
2. Detyrat dhe përgjegjësitë e Drejtorit të Drejtorisë, janë të përcaktuara me Ligjin Nr-03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale, Statutin e Komunës së Suharekës dhe me udhëzimet strategjike dhe politike të Kryetarit të Komunës e në pajtim me ligjet dhe aktet nënligjore në fuqi.
3. Ky emërim fillon nga data **17 janar 2018** dhe i njëjti mandat përfundon me përfundimin e mandatit të Kryetarit të Komunës, nëse ky emërim nuk ndërpritet më herët.
4. Drejtori, brenda tridhjetë (30) dite nga hyrja në fuqi e këtij vendimi, është i obliguar të bëjë deklarinë e pasurisë, në pajtim me nenin 7, të Ligjit Nr. 04/L-050, për deklarinë, prejardhjen dhe kontrollin e pasurisë së zyrtarëve të lartë publik dhe deklarinë, prejardhjen dhe kontrollin e dhuratave për të gjithë personat zyrtarë si dhe deklarinë pas largimit nga funksioni, brenda afatit tridhjetë (30) ditor, në pajtim me nenin 10, të këtij ligji, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 04/L-228.
5. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryetari.

Bali MUHARREMAJ

Kryetari i Komunës